



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 885/7 Prot.

Tiranë, më 23.09.2024

V E N D I M

Nr. 253, Datë 23.09.2024

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 129, datë 10.06.2024¹, e paraqitur nga z. L.K, i përfaqësuar me prokurë² nga z. E.M kundër Bashkisë Vorë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike³”, “aftësisë së kufizuar” dhe “çdo shkak tjetër⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me shkresën e protokolluar me tonën nr. 885/3, datë 24.06.2024, subjekti ankues, ka parashtruar se: “Në vitin 2019 ka ndodhur një fatkeqësi natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019. Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë”. Banesa u dëmtua nga tërmeti i datës 27.11.2019. Kjo gjë vërtetohet nga Akt Ekspertiza e Thelluar, lëshuar me datë 15.02.2020, nga Instituti i Ndërtimit.

Në banesë kemi jetuar 3 familje (në total 12 anëtarë). Babai jonë S.K ka bërë aplikimin nr. 244, datë 06.02.2020 pranë Bashkisë Vorë. Familjet tona që nga rënia e tërmetit kanë marrë vazhdimisht bonusin e qirasë sipas aplikimit që kemi bërë. Që nga koha e rënies së tërmetit jemi

¹ Me shkresën nr. 885/2, datë 13.06.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar nga ankuesi shpjegime dhe plotësim dokumentacioni.

² Referuar Prokurës së Posaçme, nr. Repertori 592, nr. Koleksioni 251, datë 09.05.2023 të Noteres F.N.I.

³ Familja e z. L.K është vënë në gjendje të vështirë ekonomike, pasi prej më shumë se 1 viti, po e paguan vetë qiranë e banesës.

⁴ Pa përcaktuar një cilësi personale apo shkak.

interesuar pranë Bashkisë Vorë për të aplikuar si dhe për ecurinë e banesave që do përfitonim dhe duke qenë se na është lejuar vetëm aplikimi i babait dhe na është thënë që ju do të përfitoni banesat. Pra na është sqaruar që ju nuk mund të aplikoni dot por do të përfitoni banesat sipas Udhëzuesit DS5 dhe nuk ka nevojë për asnjë aplikim tjetër.

Bazuar në Udhëzuesin DS5, na është kërkuar nga Bashkia Vorë, Deklaratë Noteriale e nënshkruar përpara noterit nga kryefamiljarët e familjeve, kryetari i fshatit dhe minimalisht tre fqinjë të cilët konfirmojnë faktin që ne kemi jetuar aty. Është përpiluar kontrata noteriale me Nr. Repertori: 3296 dhe Nr. Koleksioni: 1911, datë 06.08.2020 dhe është dorëzuar pranë Bashkisë Vorë, konform Pikës 2 të Udhëzuesit DS5, sipas kërkesës së Bashkisë Vorë.

Me ankesën e datës 12.09.2022 i jam drejtuar Bashkisë Vorë ku kam bërë kujtesë mbi kërkesën e bërë për rishqyrtim të dosjes me nr. 244, datë 06.02.2020. Prej kohës që është dorëzuar nuk kam më asnjë informacion edhe pse i jemi drejtuar Bashkisë Vorë me kërkesa dhe ankesa për ecurinë e çështjes.

Me prokurën e posaçme Nr. Repertori: 592 dhe Nr. Koleksioni: 251, datë 09.05.2023, është caktuar si përfaqësues me prokurë z. E.M.

Unë z. E.M i jam drejtuar Bashkisë Vorë me ankesë, datë 26.12.2023 me objekt:

- 1. Përfitimi i objektit individual të banimit të z. L.K, sipas udhëzuesit DS5.*
- 2. Ankesë për mosdhënie e bonusit të qirasë për z. L.K prej më shumë se 6 muajsh.*

Me shkresën kthim përgjigje nr. 87, datë 05.01.2024, Bashkia Vorë ka dhënë informacion për numrin e aplikimit dhe ka vendosur në dispozicion kopjen e dosjes. Bashkia Vorë nuk ka gjetur asnjë zgjidhje për objektin e ankesës.

Me ankesën drejtuar përsëri Bashkisë Vorë me datë 02.04.2024, i është kërkuar konform procedurave administrative rishqyrtimi i ankesës dhe gjetjen e zgjidhjes brenda afatit të arsyeshëm sipas pikave të ankesës.

Me shkresën kthim përgjigje nr. 1741/1, datë 09.04.2024, Bashkia Vorë ka sqaruar se: “Për sa më sipër z. L.K është përllogaritur përfitues në aplikimin e babait të tij i cili ka qenë pronari i objektit të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019. Subjektet të cilët nuk kanë patur objekt të dëmtuar nga tërmeti nuk kanë patur të drejtë ligjore për të aplikuar për tu trajtuar nga procesi i rindërtimit”.

Kjo përgjigje bie në kundërshtim me Udhëzuesin DS5 në të cilin sqarohet se: “Nëse në një objekt banimi (shtëpi private) dy ose më shumë kate ose një ndërtesë një kat me një ose më shumë hyrje, kanë jetuar më shumë se një familje dhe për këtë objekt ka aplikuar vetëm njëri nga pronarët e ndërtesës së përbashkët, secila nga familjet duhet të vërtetojë që ka jetuar në të njëjtën ndërtesë nëpërmjet një deklarate noteriale të nënshkruar para noterit nga kryefamiljarët e familjeve, kryetari i fshatit/koordinatori i qytetit dhe minimalisht tre fqinjë të cilët konfirmojnë faktin. Në këtë rast secila familje do të përfitojë objekt individual banimi sipas numrit të

pjesëtarëve të familjes. Në asnjë rast nuk do të pranohen pjesëtarë të tjerë familje, përveç atyre të deklaruar në momentin e aplikimit”.

Gjithashtu të 3 familjet kanë marrë bonusin e qirasë, pra të 3 familjet janë përfituese sipas Udhëzimit DS5, pasi nëse nuk do të ishin përfitues nuk duhet të përfitonin bonusin e qirasë.

Familja e z. L.K përbëhet nga 3 anëtarë ku përfshihet E.K (bashkëshortja) dhe A.K (djali). Bashkëshortja e z. L.K është me aftësi të kufizuara, kjo vërtetohet nga: - Libreza nr. 818, datë 01.11.2022 e vlefshme deri me datë 01.11.2023, e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror; - Vendimi i Zyrës Rajonale të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, me nr. Vendimi AK-2023-029596, datë 25.10.2023 e vlefshme deri me datë 01.11.2025.

Ndodhur në këto kushte Bashkia Vorë e ka diskriminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë familjen e z. L.K, pasi në të njëjtën situatë është dhe fqinji i tij z. B.S, z. K.S dhe z. P.S, i cili ka përfituar banesë individuale veç nga vëllai i tij, pra është në të njëjtat kushte si familja e z. L.K dhe kanë përfituar 2 banesa, pra janë në të njëjtat kushte dhe janë trajtuar ndryshe.

Gjithashtu në fshatin Marikaj ka dhe raste të tjera që kanë banuar 2 ose më shumë familje në një banesë dhe kanë përfituar banesat individuale, ndërsa 3 familjet S.K, jo.

Deri tani jemi në kushtet kur z. L.K ka ikur emigrant, znj. E.K është me aftësi të kufizuara, djali është student dhe qiranë e banesës ku jetojnë aktualisht po e paguajnë vetë, pasi Bashkia Vorë e ka ndërprerë bonusin e qirasë pa dhënë asnjë arsye ose njoftim”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe detyrimin e Bashkisë Vorë të marrë masat që z. L.K të përfitojë objektin e banimit individual sipas Udhëzuesit DS5 dhe ti japë bonusin e qirasë së prapambetur si dhe në vazhdim, deri në ndërtimin e banesës së z. L.K.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore

të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, apo në raport me të drejtat e tyre ligjore.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkëlqet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 885/4, datë 01.07.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Vorë, për ankesën e bërë, si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:

- Kopje të plotë të dosjes së aplikimit dhe të përfitimit nga programi i zhvillimit të objekteve të reja të z. S.K.
- Informacion dhe kopje të dosjes së përfitimit të bonusit të qirasë të të tre familjeve K dhe arsyet e ndërprerjes së bonusit të qirasë.
- Informacion dhe kopje dokumentacioni, nëse ka dhe familje të tjera, të cilëve i është ndërprerë bonusi i qirasë, të cilat janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin.
- Kopje të të gjithë korrespondencës shkresore, (përfshirë ankesat) që Bashkia Vorë ka pasur me ankuesin, lidhur me problematikat, objekt i ankesës.
- Kopje të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 65, datë 04.09.2020 dhe të listës së subjekteve përfituese nga programi i zhvillimit të objekteve të reja në Bashkinë Vorë.
- Kopje të Vendimit nr. 47, datë 10.07.2020 të Këshillit Bashkiak Vorë, *“Për miratimin e udhëzuesit për detajimin e procedurave për të përfituar nga programi i zhvillimit të objekteve të reja dhe programi i rindërtimit DS5 si dhe problematikave të hasura gjatë procesit të pranimit dhe plotësimit të dokumentacionit”* dhe të Udhëzuesit DS5.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit të aplikimit dhe përfitimit nga programi i zhvillimit të objekteve të reja të personave: B.S, K.S dhe P.S.
- Informacion nëse ka dhe aplikues të tjerë, të cilët janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin dhe si janë trajtuar ato.

Me shkresën nr. 3031/1, datë 02.08.2024, Bashkia Vorë në mes të tjerash, informoi Komisionerin se: *“Pranë Zyrës së Rindërtimit, Bashkia Vorë nga kërkimet në bazën e të dhënave të gjendur në sistemin online në Platformën Shqipëria Solidare (zyra përkatëse e rindërtimit), në sistemin e aplikimeve online gjendet aplikimi në emër të z. S.K (babait të z. L.K).*

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen civile”, neni 30, VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore” dhe Vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, “Për Përcaktimin e Rregullave dhe të Procedurave për Përfitimet nga Programi i Grandeve të Rindërtimit dhe Projekt Model”, i ndryshuar me Vendimin nr. 282, datë 09.04.2020, i ndryshuar me Vendimin nr. 401, datë 19.05.2020, Komisioni i Vlerësimit të Ankesave ju paraqet informacionin e kërkuar lidhur me procesin e rindërtimit. Bashkia Vorë, referuar rastit në fjalë, trajtuar nga Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit për aplikuesin z. S.K i cili është shpallur përfitues i Grantit për Rindërtim me nivel dëmi DS5 për objektin e ndodhur në Marikaj në emër të z. S.K, me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 65, datë 04.09.2020, ku gjendet i përfshirë me nr. 12, familjarësh dhe z. L.K.

Për sa më sipër z. L.S.K është përllogaritur përfitues në aplikimin e babait të tij, i cili ka qenë pronari i objektit të dëmtuar nga tërmeti i rënë në datë 26.11.2019.

Subjektet të cilët nuk kanë patur objekt të dëmtuar nga tërmeti nuk kanë patur të drejtë ligjore për të aplikuar për tu trajtuar nga procesi i rindërtimit, gjithashtu referuar dhe Udhëzuesit DS5 cituar dhe në shkresën tuaj. Sipas numrit të familjarëve, z. S.K dhe L.K kanë përfituar Grandin

në vlerë për rindërtimin e sipërfaqes maksimale që ofrohet nga Procesi i Rindërtimit me (strukturë 3+1).

Gjithashtu për z. L.K ju është vënë në dispozicion sipas kërkesës së tij apo me autorizues, si në rastin në fjalë disa herë kthime përgjigje sipas lëndës së kërkesës së kërkuar prej tij, gjë për të cilën po ju vëmë në dispozicion kthimet e përgjigjeve të herë pas hershme.

Për sa i përket familjarëve S të cilët janë trajtuar nga Komisioni i Posaqëm i Rindërtimit dalë përfitues me aplikues z. K.S dalë përfitues me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 60, datë 12.08.2020, me kryefamiljarë 2, z. K.S me kategori dëmi DS5.

Për sqarim: Komisioni i Posaqëm i Rindërtimit ka trajtuar dosjen e familjarëve S në dispozitat e lartpërmendura referuar çdo vërtetimi plotësues, të dosjes ku gjendet si dokument plotësues Deklarata Noteriale lëshuar me datë 05.08.2020 dhe vërtetim nga Kryetari i Fshatit Marikaj me datë 24.02.2020, ku ka cituar se z. P.S ka jetuar në një kulm me banesën e babait të tij z. B.S, por me hyrje të ndryshme, ku bashkëngjitur gjenden dhe faturat e OSHEE-së, taksat familjare të paguara dhe kontratë uji në emrin e tij, si kryefamiljarë më vete.

Lidhur me pikën e cituar për bonusin e qirasë, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit ka paguar Bonusin e Qirasë deri në periudhën Mars 2023, nga kjo periudhë e në vazhdim Bonusi i Qirasë për familjet e prekura nga tërmeti rezulton i papaguar për mungesë fondesh. Bashkia Vorë është në pamundësi financiare për të përballuar bonuset e qirasë nga të ardhurat e veta”.

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Vorë, përfaqësuesi i ankuesit me shkresën e dërguar me e-mail-in datë 14.08.2024, ka kundërshtuar informacionin e Bashkisë Vorë, duke informuar si vijon: “Shkresa e Bashkisë Vorë bie në kundërshtim me: Udhëzuesin DS5 “Për detajimin e procedurave për të përfutur nga programi i zhvillimit të objekteve të reja dhe programi i rindërtimit si dhe problematikave të hasura gjatë procesit të pranimi dhe plotësimit të dokumentacionit”, Faza e parë, Neni 5, Pika 2 sqarohet se: “Nëse në një objekt banimi (shtëpi private) dy ose më shumë kate, ose një ndërtesë një kat me një ose më shumë hyrje, kanë jetuar më shumë se një familje dhe për këtë objekt ka aplikuar vetëm njeri nga pronarët e ndërtesës së përbashkët, secila nga familjet duhet të vërtetojë që ka jetuar në të njëjtën ndërtesë nëpërmjet një deklarate noteriale të nënshkruar para noterit nga kryefamiljarët e familjeve, kryetari i fshatit/koordinatori i qytetit, dhe minimalisht tre fqinj të cilët konfirmojnë faktin.

Në këtë rast secila familje do të përfutojë objekt individual banimi sipas numrit të pjesëtarëve të familjes. Në asnjë rast nuk do të pranohen pjesëtar të tjerë familje, përveç atyre të deklaruar në momentin e aplikimit”.

Pra jemi në rastin konkret ku familja e z. L.K është në të njëjtat kushte si 2 familjet S.

Gjithashtu Udhëzuesi e ka bërë të qartë që dhe për këtë objekt ka aplikuar vetëm njëri nga pronarët e ndërtesës së përbashkët, secila nga familjet duhet të vërtetojë që ka jetuar në të njëjtën

ndërtesë nëpërmjet një deklarate noteriale të nënshkruar para noterit nga kryefamiljarët e familjeve, kryetari i fshatit/koordinatori i qytetit dhe minimalisht tre fqinj të cilët konfirmojnë faktin.

Kushti i parë është që duhet të aplikojë minimumi vetëm një nga pronarët. Pra, në rastin konkret ka aplikuar vetëm njëri nga pronarët pasi aplikimi nuk është marrë nga ana e Bashkisë Vorë edhe pse familjet K janë interesuar pranë bashkisë.

Kushti i dytë është që të përpilohet deklarata noteriale e nënshkruar pranë noterit nga kryefamiljari, kryetari i fshatit dhe minimalisht 3 fqinj të cilët konfirmojnë faktin.

Rezulton se kjo deklaratë është kërkuar nga Bashkia Vorë dhe është dorëzuar nga familja K, deklarata e cila ndodhet në dosjen objekt ankimi. Rezulton se familjet K dhe S janë në kushte të barabarta, por janë trajtuar ndryshe”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për përfitimin e objektit individual të banimit të z. L.K.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Për shkak të fatkeqësisë natyrore, si shkak i tërmetit që preku Shqipërinë në datë 26 Nëntor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “*Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore*”, i cili në Nenin 5 ka përcaktuar subjektet përfituese. Kështu në pikën 1 të nenit 5 përcaktohet se: “*Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore*”.

Në nenin 18, pika 7 të Aktit të sipërcituar është parashikuar se: “*7. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”.

Në zbatim të aktit të mësipërm, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019 “*Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit*”, ka përcaktuar se: “1. 2.

3. Aplikimi për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi bëhet me dy faza. Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t’u trajtuar me njërin prej këtyre programeve.

4. 5. 6. 10.

11. Faza e dytë e aplikimit fillon në momentin e vënies në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit. Bazuar në kërkesat specifike të çdo programi, njësia e vetëqeverisjes vendore ndjek procedurat, si më poshtë vijon: a. b. c. ç. d.;

dh) njofton familjet që përfitojnë nga programet specifike të procesit të rindërtimit, si dhe ata/o që nuk kanë përfituar, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kandidatët që nuk kanë fituar caktohen të përfitojnë nga një program tjetër i procesit të rindërtimit.

12. 13. 19.;

20. Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në aktin normativ që rregullon përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Subjektet përfituese nga programet e procesit të rindërtimit trajtohen dhe përfitojnë, si më poshtë vijon: 20.1.

20.2. Familjet në qytet, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes, përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja ose programi i granteve të rindërtimit ose programi i fondit të banesave. a) b)

c) Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet shtetërore përgjegjëse vendosin që të trajtojnë përfituesin me grant për rindërtimin e shtëpisë individuale zbatojnë kushtet dhe rregullat sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Tabela A. Për familjet me përbërje familjare, 5 e më shumë anëtarë; Struktura e apartamentit 3+1; Sipërfaqja 90 m² deri 100 m².

Tabela B. Për familjet me përbërje familjare, 5 e më shumë anëtarë; Sipërfaqja jo më pak se 90 m².

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Vorë, me Vendimin nr. 47, datë 10.07.2020 ka miratuar udhëzimin “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga programi i zhvillimit të të objekteve të reja dhe program i rindërtimit si dhe problematikave të hasura gjatë procesit të pranimit dhe plotësimit të dokumentacionit”.

Në Kreun IX të këtij udhëzuesi përcaktohet se:

“Referuar pikës 3 të Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, aplikimi për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi bëhet në dy faza.

- Në fazën e parë, aplikantët paraqesin kërkesën e tyre së bashku me dokumentat e kërkuara për të përfituar nga program i rindërtimit.
- Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t’u trajtuar nga programet e rindërtimit.

I. Faza e dytë e aplikimit.

8.3 Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit: a.

b. vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të vendimeve të Këshillit të Ministrave si dhe harton listën e subjekteve përfitues/jopërfitues të programit të rindërtimit pranë Kryetarit të Bashkisë.

8.4 Kryetari i Bashkisë:

Kryetari vendos brenda 10 (dhjetë) ditëve pune për listën e fituesve.

8.5 Zyra e Posaçme e Rindërtimit merr të gjitha masat e nevojshme që nëpërmjet Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun të njoftojë aplikuesit që përfitojnë nga programi i rindërtimit dhe ato që nuk përfitojnë. Individët/familjet që pretendojnë se vlerësimi i shkallës së dëmtimeve nuk përputhet me dëmin real të shkaktuar në banesat e tyre, si dhe aplikantët që nuk rezultojnë përfitues nga ky nënprogram, kanë të drejtën e ankimit.

8.6 Subjektet jo fituese mund të paraqesin ankesat e tyre në Bashkinë Vorë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, pranë zyrave të informacionit.

Pas përfundimit të afatit/shqyrtimit të ankesave dhe pas marrjes së të dhënave në lidhje me subjektet ankimuese, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik ndjek procesin e hartimit të projektvendimit për miratimin e listës së subjekteve përfituese, për t'ia paraqitur për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak.

8.7 Këshilli Bashkiak miraton listën për aplikantët fitues për rindërtimin e banesave/lagjet e reja për individët ose familjet përfituese.

Pas hyrjes në fuqi të vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun shpall listën e përfituesve në stendën e buletineve për publikun, faqen e internetit të Bashkisë dhe/ose në vende të tjera publike. Ky proces, më pas finalizohet me lidhjen e kontratës, formati tip i së cilës është bashkëlidhur VKM 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”.

Në shqyrtim të legjislacionit të sipërcituar, rezulton se Këshilli i Ministrave ka parashikuar se për të përfituar nga programet e rindërtimit, subjektet individë/familje, duhet të aplikojnë në njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përfituar nga njëri prej programeve të rindërtimit.

Referuar dokumentit Akt Ekspertizë e Thelluar, datë 15.02.2020, të Institutit të Ndërtimit, rezulton se nga tërmeti i datës 26.11.2019, shtëpia ku banonte ankuesi me adresë: Rruga: “Malsubash”, Ndërtesa 15, Vorë, është shpallur me nivel dëmtimi DS-5 dhe është rekomanduar prishja e ndërtesës ekzistuese dhe ndërtimi i një ndërtese të re.

Referuar Çertifikatës për Vërtetimin e Pronësisë nr. 1461319, datë 16.03.2017 të pasurisë nr. 380/11/1, Zona Kadastrale 2596, Marikaj, rezulton se prona e dëmtuar nga tërmeti është në pronësi të z. S.K.

Bazuar në legjislacionin e sipërcituar, z. S.K me formularin nr. 8319, datë 06.02.2020, ka aplikuar pranë Bashkisë Vorë, për t'u trajtuar me grantin për rindërtim, me përbërje familjare prej 12 personash.

Referuar dokumentit “Vërtetim që konfirmon regjistrimin e aplikimit, objektin, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura”, të dorëzuar në dosjet e aplikimit, rezulton se aplikimi i z. S.K të dorëzuar në datë 06.02.2020, pranë Bashkisë Vorë, ka qenë pa të meta dhe ka pasë të bashkëlidhur një dokument: Certifikatë për vërtetim pronësie.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Vorë me Vendimin nr. 65, datë 04.09.2020 ka miratuar listën e përfituesve nga procesi i rindërtimit në kuadër të tërmetit të datës 26.11.2019 për kategorinë DS5. Në këtë listë figuron fitues me numrin rendor 5 dhe z. S.K (dy persona), me përbërje familjare 12 persona, ku përfshihet familja e z. L.K (tre persona) dhe familja e z. T.K (shtatë persona).

Nga shqyrtimi i ankesës dhe bazuar në nenin 33/4, germa “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuuese”, Komisioneri vlerëson se ky pretendim i parashtruar në ankesë, nuk duhet të pranohet pasi është paraqitur përtej afateve ligjore të parashikuara nga germa “dh”, e pikës 4, të dispozitës ligjore të sipërcituar, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, formulimi në nenin 33/4, germa “dh”, e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon se afati maksimal 3 vjeçar, nga momenti i ndodhjes së diskriminimit dhe afati maksimal 2 vjeçar, nga momenti i marrjes dijani për diskriminimin, nuk janë afate kumulative.

Së dyti, fakti diskriminues i pretenduar nga ankuesi, rezulton të ketë ndodhur në datë 04.09.2020 kur Këshilli Bashkiak i Bashkisë Vorë me Vendimin 65, datë 04.09.2020, ka shpallur listën e përfituesve nga procesi i rindërtimit. Z. L.K si pjesëtar i familjes së z. S.K ka pasë dijani për shpalljen si përfitues nga procesi i rindërtimit, pasi njoftimi i Bashkisë Vorë ka qenë publik. Gjithashtu ankuesi ka pasur dijani të përfitimit të grantit të rindërtimit, kur me shkresën datë 12.09.2022, me lëndë “Kujtesë mbi kërkesën për rishqyrtim të dosjes së rindërtimit me nr. 244, datë 06.02.2020, në emër të z. S.K”, i është drejtuar Bashkisë Vorë në të cilën i ka kërkuar: “Në mbështetje të kërkesës datë 05.01.2022 ku akoma nga Bashkia Vorë nuk kam asnjë përgjigje zyrtare nëse janë marrë masa për rishqyrtimin e dosjes së mësipërme sipas problematikës së shpjeguar në kërkesë dhe zgjidhjen e saj.”.

Ankuesi ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit, në datën 10.06.2024 dhe e ka plotësuar atë në datë 24.06.2024, pra në tejkallim të afatit 2 vjeçar të parashikuar në nenin 33/4, germa “dh”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Pra, konkludojmë se janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

⁵ Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023 dhe nr. 167, datë 23.08.2023 të Komisionerit.

Nga ana tjetër, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁶, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

B. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe të pafavorshëm, të ankuesit për përfitimin e bonusit të qirasë.

Në nenin 26 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”, është parashikuar se: “Pagesa e qirasë.”

1. Familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, të mbetura të pastreha pasi banesat ose shtëpitë e banimit individuale të tyre janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm, përfitojnë një pagesë qiraje në vlerën mesatare të tregut të lirë, për një vit, që miratohet me vendim të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore.
2. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese aplikojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin, duke dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:
 - a) Formularin e aplikimit sipas formati të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
 - b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;
 - c) Certifikatën familjare;
 - ç) Numrin e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e përsheptuara për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimin përkatës të subjekteve përfituese dhe të nivelit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
4. Pagesa e qirasë, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të miratohet deri në përfitimin e banesës së re nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose deri në përfundimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të banesës, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit të parashikuara në këtë ligj, nëse përfituesi plotëson kriteret dhe dokumentacionin përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për strehimin social.
5. Shpenzimet e qirasë përballohen nga fondi i rindërtimit, si dhe nga të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më lart, bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së, nga palët, rezulton që familja e z. L.K, nga periudha janar 2020 deri në muajin mars 2023, ka përfituar trajtimin me bonus qiraje për familjen e tij.

⁶ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar: “Procedura para gjykatës”.

Referuar përgjigjes së dhënë nga Bashkia Vorë, me shkresën nr. 3031, datë 02.08.2024, në të cilën informon se nga periudha prill 2023 e në vazhdim bonusi i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti nuk është paguar për mungesë fondesh, rezulton se bonusi i qirasë nuk është dhënë për asnjë prej familjeve të prekura nga tërmeti, që janë banorë të Bashkisë Vorë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se mospagesa e bonusit të qirasë për familjet e prekura nga tërmeti, banorë të Bashkisë Vorë, është bërë për arsye të justifikuar, për shkak të pamundësisë financiare për të përballuar bonuset e qirasë nga të ardhurat e vetë Bashkisë Vorë, jo vetëm për familjen e z. L.K, por për të gjitha familjet e Bashkisë Vorë të prekura nga tërmeti.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Neni 20, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, siguron mbrojtje të individëve nga diskriminimi në fushën e të mirave e shërbimeve. Neni 20, parashikon shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

b) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Bashkia Vorë, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo të pafavorshëm.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Vorë, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi lidhur me mospërfitimin e pagesës së bonusit të qirasë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. L.K, për shkak të gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Vorë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA